



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, neni 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., neni 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 4249 të datës 03.08.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, Trepça Sh.A me datë 05.05.2026 publikon këtë:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Përgjegjës në dromcoren sekondare
Koeficienti/Paga	640€ bruto
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit	05/05/2026
Afati për aplikim	06/05/2026- 20/05/2026
Institucioni	Ndërmarrja “Trepça Sh.A.”
Njësia Biznesore	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Zbaton urdhërat që i merr nga mbikëqyrësi i Linjës së Thërmimit dhe udhëheqësit tjerë përkatës;
- Bën përcjelljen e të gjithë parametrave në dromcoren sekondare;
- Përcjell punën prej shiritin nr.5 deri te shiriti nr. 12 duke përfshir edhe punën e dromcores sekondare;
- Përcjell gjendjen e lybrifikimit në dromcoren sekondare;
- Nëse parashihet të punohet në dromcore 24 orë, pranim- dorëzimi i punës duhet të bëhet në vendin e punës;
- Është i obliguar të respektoj orarin e punës;
- Obligohet t'i përdor mjetet mbrojtëse për vendin e punës dhe zbaton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- Angazhohet edhe në vende tjera të punës, sipas nevojës;
- Duhet të punoj edhe jashtë orarit të punës, sipas nevojës;
- Për zbatimin dhe mos zbatimin e detyrave të punës i nënshtrohet masave stimuluese dhe ndëshkuese, sipas rregullores së punës.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme ose mesëm të ulët;
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/>, tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.


8. Shpallja e rezultateve përfundimtar

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.

Kryeshefi Ekzekutiv



Faton Ahmeti